

## EKSTRAKT NGA INTERVISTA

*[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 16 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]*

**Intervistuesja:** A mundësh me më kallxu pak ma shumë për fëmijërinë tonde, çfarë fëmijërie ke pasë?

**Narratorja:** Kom lindë në Batllavë, atje e kom familjen. Nejse, prindët nuk i kom, po familjen, vllaznit tjerët krejt. Po mirë kemi kalue fëminia mirë, mirë u konë. Me qato kushte të veta si prindët, si familja, mirë. S’jemi konë në kushte shumë të fshtira se edhe koha u konë atëherë qysh u konë e dimë, po mirë. Shembull, e ke kry orarin e mësimit, ke shku në shpi, je marrë me punë të shpisë të cilat t’i ka caktue nana, po jo shumë ashtu me na mundu si nanat tjera. Jo si naj nanë e shumë fëmive që veç ja u ka lëshue punën edhe, “Veç ki me bo qit punë. Po nëse ju doni, nëse ju s’doni...”. Po na jena konë të interesum edhe ndërgjegja jonë s’na ka leju diqysh na me nejt e me pa nanën t’u punu apo dikon tjetër. Jena marrë me pune kudo që na kanë dhonë. Jena marrë me pune, jena ardhë në shpi tamam me orar të caktuem. S’jena vonu, gjithçka në rregull u konë.

**Intervistuesja:** Çfarë pune bojshe ti?

**Narratorja:** Po punët e shpisë, po nashta edhe punët e tokës, shembull nashta je marrë edhe në bashçe je dalë ke punu diçka. A din, ju ke ndihmue prindëve, për që me thonë me dalë kështu, qytetin shumë pak e kena pa, shumë pak se s’kena dalë. Jo, jo, se atëherë jo fjalë, jo pak katuni i ka pasë, i ka pasë do krejt ndryshime prej qytetit. Edhe shembull, liqenin e kena pasë afër, shumë pak e kena pa. “Jo, se s’bon, se filanja ka shku te liqeni, ajo nuk bon, nuk osht’ e sjellshme” (qesh). A po kupton? Do sene jonë konë kështu primitive diqysh.

**Intervistuesja:** A din me notu ti?

**Narratorja:** Po, po, se na e kena pasë lumin afër, në lumë. Po liqenin shumë pak e kena pa se, “Jo filanja edhe na jem fetarë tash me ju pa hallki” shembull, “juve aty te liqeni”. Edhe e kena ndalë veten qysh na kanë thonë qashtu kena vepru. Se edhe koha u konë atëherë qysh u konë e dimë, po mirë, mirë.

**Intervistuesja:** Me çka është marrë baba jot?

**Narratorja:** Valla baba jem bujk u konë, me tokë, bashçen, këto krejt. Krejt ja ka arritë qëllimin edhe na ka majt domethonë me ushqim me krejt, natyrale, krejt a. Edhe s'u konë keq.

**Intervistuesja:** E mami, nana?

**Narratorja:** Nana, me punët e shpisë edhe ajo me bashçe, me qashtu, si krejt.

**Intervistuesja:** Me cilin prej prindërve ke qenë ma e afërt?

**Narratorja:** Ma e afërt kom qenë me nanën.

**Intervistuesja:** Pse?

**Narratorja:** Po, s'e di, na femrat jemi ma të ndjeshme edhe i kuptojmë do, do punë ma shumë, edhe ma të ndishme pak. E kom pasë ni nonë shumë të nalne, shumë, gjithëherë na ka eduku, na ka mësu gjithëherë për mirë, jo për keq. Edhe e kena marrë gjithëherë edukatën e tyne qysh na kanë këshillu edhe qashtu kena vepru tani. Jo, shembull si sot, se s'i pëlqejnë ato nashti dikuj edhe pse jena konë taman. Kur u fol fjala e kena majt edhe qashtu kena vepru, mo s'ka pasë aty najfarë, shembull najfarë ndryshimi pse ashtu me bo. Veç jena mundu me ju përmbajt qatyne edhe s'ka mo. Po unë sot edhe pse më kanë vdekë prindët i falenderoj. Allahu thomë i pastë shpërblye me xhenet, "Sa mësim të mira na paske dhonë, çfarë edukate, çfarë..." Se ato e kom majtë deri tash e kom me majt deri sa të vdes, se të mirat m'i lonë kurrë.

**Intervistuesja:** Kallxom, a ke motra edhe vllazën?

**Narratorja:** Po kom motra e vllazën, katër vllazën i kom, dy motra.

**Intervistuesja:** Me cilën prej tyne ke qenë ma e afërt?

**Narratorja:** Kom qenë me motrën mas meje, i kemi 18 mujë nërmjet me to edhe jena konë si binjake. Kush na ka pa nuk e ka ditë që s'jemi binjake me ta.

**Intervistuesja:** A jeni hala qashtu?

**Narratorja:** Po ajo u pat martu, pat jetu në Angli dymdhetë vjet. Po tash për shkak të fëmive s'kanë dashtë atje m'i lanë i kanë kthye fëminë edhe kanë ardhë këtu jetojnë në këtë fshatin Prugovc. Edhe

tash hale jemi qashtu në kontakt me to, kuptohet jo si përpara se secila i ka obligimet e veta. Po, apet e kem qat dashni, qat... s'mujna me nejt pa njona-tjetrën.

**Intervistuesja:** Kallxom, çfarë fëmije ki qenë?

**Narratorja:** Fëmi shumë i nalun, shumë i sjellshëm, shumë i edukum. Në shkollë, tetëvjeçaren e kom të kryme se atëherë për shkak të udhëtimit edhe pse, pse shumë jom konë e flaktë me vazhdu shkollimin nuk kom pasë mundësi se për shkak të udhëtimit, lidhja e autobusav u konë shumë e dobët. Edhe nuk kom mujt, po sot ondërr e kom shkollën. Ja kisha arrit qëllimin, se jom konë ni fëmi shumë aktiv diqysh në çdo sen. Merrshum pjesë në shfaqje, si këngëtare jom konë ma e mira, ne recitime. Edhe sot ku kom metë s'kom mujt me kallxu veten a po kupton, me arrit qëllimin edhe fshtirë, s'osht' lehtë. Po sot më pëlqejnë femrat që jonë të shkollume, të zoja të vetit, krejt të pamvarne, shumë më pëlqejnë edhe e ni veten shumë mirë, e knaqët kur i shoh.